




UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues

Nr. ref. 151

Prizren, 07.07.2020

Këshilli Drejtues bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621 si dhe dispozitat tjera ligjore në fuqi, merr vendim për të shpall:

KONKURS

Për lirim nga pagesa e semestrit për studentët e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren për vitin akademik 2019/2020, për kategoritë si më poshtë:

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale si dhe studentët me aftësi të kufizuara fizike;
2. Studentët, të cilët janë invalidë ose veteranë të luftës, studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës dhe fëmijët e invalidëve ose veteranëve të luftës;
3. Studentët e të njëjtit prind i cili ka dy (2) e me shumë studentë në studime në Universitetet publike të Kosovës.

Shënim:

- Studentët e vitit të parë të nivelit baçelor nuk mund të jenë pjesë e këtij konkursi, pasi që viti i parë i studimeve bacheloret është pa pagesë.
- Përfitues sipas pikës 1 dhe 2 të këtij konkursi janë vetëm studentët të cilët kanë kryer pagesën administrative të semestrit përkatës nuk janë liruar nga zyra për shërbime studentore.
- Studentët përsëritës që i takojnë pikës së tretë (3) nuk mund të përfitojnë nga ky konkurs.

Të gjithë studentët duhet t'i paraqesin:

- Kërkesën për lirim nga pagesa e semestrit (formular i aplikimit);
- Vërtetimin e studimeve për vitin akademik 2019 - 2020;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e llogarisë bankare (personale) si dhe
- Fletëpagesat e semestrave për të cilët aplikon (kopjen e të cilëve e ka pala ose mund të gjenden tek zyra për shërbime studentore).

1. Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale, si dhe studentët me aftësi të kufizuara fizike duhet të sjellin edhe:

- 1.1 . Dëshminë nga MPMS-ja (të vërtetuar) mbi statusin e studentit sipas pikës 1 të këtij konkursi ¹.
- 1.2 . Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të ndihmës sociale ².
- 1.3 . Çertifikatën e lindjes së studentit/es.

2. Studentët, të cilët janë invalidë ose veteranë të luftës, studentët që kanë mbetur pa njërin prind si pasojë e luftës dhe fëmijët e invalidëve ose veteranëve të luftës;

- 2.1. Kopjen e vërtetuar të vendimit nga MPMS-ja, mbi statusin e familjes së dëshmorit, viktimës civile, invalidëve dhe veteranëve.
- 2.2. Kopjen e letërnjoftimit të bartësit të statusit të familjes së dëshmorit/viktimës civile³;
- 2.3. Çertifikatën e lindjes së studentit/es.

3. Studentët e të njëjtit prind duhet të paraqesin:

- 3.1 Çertifikatën e lindjes;
- 3.2 Vërtetimin për regjistrimin e vitit akademik 2019/2020.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë zyrës së Këshillit Drejtues, Objekti i Fakultetit Ekonomik. Për shkak të gjendjes së krijuar si rezultat i pandemisë dhe me qëllim të shmangjes së kontakteve fizike, dorëzimi i aplikacioneve bëhet në kutinë për aplikim.

Afati për aplikim është prej datës, 08.07.2020 deri më: 22.07.2020.

Formularin për aplikim mund ta gjeni në faqen zyrtare të Universitetit të Prizrenit: www.uni-prizren.com.

¹ Studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale duhet të sjellin vendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me çka dëshmohet statusi familjar si dhe studentët me aftësi të kufizuara duhet të sjellin vendimin (apo ndonjë dokument tjetër vali) me të cilin dëshmohet statusi social i studentit.

² Vetëm për studentët, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale.

³ Përveç dokumentacionit të përmendur më lartë, kërkohet edhe kopja e letërnjoftimit të bartësit të vendimit për fëmijët e dëshmorëve dhe viktimave civile të luftës.